



**27.12.2023, Prishtinë**

**Për:** Bordin e Federatës së Basketbollit të Kosovës

**Cc:** Arben Fetahu, Kryetar - Federata e Basketbollit të Kosovës

**Nga:** Elvira Dushku, Sekretare e Përgjithshme – FBK

**Lënda:** Raport për aktivitetet e FBK-së të vitit 2023

Të nderuar/a,  
Anëtarë/e të Bordit të FBK-së,

Viti 2022 ishte shumë i ngjeshur me aktivitete për Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK), si në garat vendore, ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Federata e Basketbollit e Kosovës gjatë vitit që po e lëmë pas ka shënuar të arritura të mëdha, por sigurisht se ne nuk do të ishim në gjendje ta bënim këtë pa angazhimin dhe mbështetjen e të gjitha grupeve tona të interesit.

Për FBK-në ky ishte viti i dytë i implementimit të Planit Strategjik (2021-2025), plan ky nëpërmjet të cilit synon të zhvillohet dhe të rritet, andaj FBK e ka përgatitur një vizion realist për të ardhmen e Federatës nëpërmjet hartimit të këtij plani me ç' rast ne do të përpiqemi të shtyjmë potencialin tonë për zhvillim dhe për rritje të Federatës.

Ka ende shumë punë për të bërë përpara për të realizuar misionin dhe vizionin tonë, dhe këtë ne tashmë e dimë. Por, me krenari për atë që kemi arritur bashkërisht me grupet tona të interesit këtë vit, ne do të ballafaqohemi me të ardhmen me besim dhe optimizëm.

Faleminderit për mbështetjen tuaj të vazhdueshme.

Sinqerisht,

Elvira DUSHKU  
Sekretare e Përgjithshme  
Federata e Basketbollit e Kosovës

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## Më 6 janar u mbajt FIBA SCOD Klinika për gjyqtarët

Më 6 janar është mbajtur FIBA SCOD Klinika për gjyqtarët e FBK-së. Në këtë Klinikë mes sezonale pjesëmarrës kanë qenë 37 gjyqtarë nga të gjitha listat e gjyqtarëve të FBK-së. FIBA SCOD Klinika për gjyqtarët është udhëhequr nga FIBA Instruktori Nacional, Faton Kurshumlija, Instruktori i gjyqtarëve të FIBA-s, Gjorgi Piperkov.

## Krasniqi më 21 janar mori pjesë në Punëtorinë e JB NBA Ligës në Paris

Drejtori Teknik i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Krasniqi më 21 janar ka marrë pjesë në Punëtorinë e NBA Junior League, në Paris të Francës. Në këtë Punëtori kanë ligjëruar: Neal Meyer, Drejtor i NBA për Evropë dhe Lindje të Mesme, Daën Smyth, drejtoreshë e NBA International Operations, Henry Utku, udhëheqës i Programeve Zhvillimore të JR NBA, si dhe Adrian Carros, menaxher i JR NBA Ligës. Temat kanë qenë si të zhvillohen më mirë kapacitetet organizative të federatave, por edhe zhvillimin e talenteve të reja.

## Dushku më 26 janar në Barcelonë për fuqizimin e vajzave dhe grave në basketboll në kuadër të projektit PROMISE

Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Elvira Dushku më 26 janar në Barcelonë ka marrë pjesë në takimim e parë të partnerëve të projektit "PROMISE" (Një Hap Përpara për Basketbollin e Vajzave dhe Grave), takim ky që është organizuar nga Federata e Basketbollit të Katalonisë, njëherësh lidere e këtij projekti të fituar në kuadër të Bashkimit Evropian, më saktësisht nëpërmjet programeve të Erasmus+. Projekti "PROMISE" përbëhet nga 5 paketa të punës dhe FBK është përgjegjëse për implementimin e njërës nga këto paketa: "Komunikimi, Shpërndarja dhe Rritja e Ndërgjegjësimit për Mediat". Projekti "PROMISE" përbëhet nga 7 institucione që mbulojnë 6 vende evropiane siç janë: Spanja, Irlanda, Kosova, Portugalia, Franca dhe Bullgaria.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## Prej 15 deri më 19 shkurt u organizua Kupa e Kosovës në Rahovec

Kupa e Kosovës u zhvillua nga 15 deri më 19 shkurt në Rahovec, në një spektakël të basketbollit. Trepça është fituese e Kupës së Kosovës, duke mbrojtur trofeun e fituar vitin e kaluar. Mitrovicasit në finale mundën Sigal Prishtinën me rezultat 74:66, takim që u vendos në dhjetë minutat e fundit. Më herët 'Xehetarët' mundën Rahovecin dhe Vëllaznimin. MVP i Final 8 është shpallur Drilon Hajrizi.

Bashkimi te femrat fitoi për herë të dytë radhazi Kupën, ku në finale fitoi ndaj Prishtinës me rezultat 94:72. Pjesa e parë ishte më e barabartë, por dallimi u bë në pjesën e dytë me prizrenaset që triumfuan dhe festuan në fund. MVP e finales është shpallur Khadija Haywood.

Bora fitoi Kupën e Ligës së Parë te meshkujt. Skuadra prishtinase në finale mundi New Basket me rezultat 104:62. MVP është shpallur Dion Haxhosaj i Bora-s.

## FBK me kampanjë anti-doping në basketboll

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) në muajin shkurt të këtij viti ka zhvilluar kampanjën anti-doping në basketboll. FBK ka vizituar klubet seniore në të dyja konkurrencat, ndërsa zyrtarët e FBK-së kanë treguar për pasojat që sjell doping u në sport, përkatësisht në basketboll dhe përgjegjësitë e lojtarëve.

Kampanja është mirëpritur nga klubet e basketbollit, duke u njohur nga afër për pasojat që sjell doping u. FBK ka marrëveshje me Agjencinë e Anti-Dopingut për Kosovë (KosADA) nga viti 2022. Gjithashtu FBK është përkujdesur që në fillim të këtij viti të shpërndajë listën e WADA-s me substanca dhe metoda të ndaluara 2023 te të gjithë klubet e basketbollit. FBK ka shpërndarë video dhe informacione në rrjetet sociale gjatë 3 muajve për ndërgjegjësimin e basketbollistëve dhe punëtorëve sportiv rreth dukurive negative të dopingut.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## Astera Tuhina, kampione e Konferencës PAC-12

Një sukses historik për ekipin e Washington State Cougars dhe basketbollisten e Përfaqësueses së Kosovës, Astera Tuhina, që është shpallur kampione e Konferencës PAC-12, duke mposhtur UCLA me rezultat 65:61 në Las Vegas. Astera ka luajtur rol kyç në triumfin e ekipit të saj në debutimin e saj në këtë ligë. Tuhina në finale ka luajtur për 31 minuta, duke realizuar gjashtë pikë, gjashtë asistime dhe tri kërcime, duke marrë vlerësime shumë pozitive për paraqitjen në finale, por edhe gjatë gjithë këtij edicioni. Washington State Cougars u shpall kampione më 6 mars.

## Enisa Kamerolli me suksese në SHBA

Ekipi i basketbollit UT Tyler, ku pjesë është edhe basketbollistja e Kosovës, Enisa Kamerolli, vazhdoi me suksese. UT Tyler u kualifikuan në turneun e parë NCAA DII dhe pasi kanë fituar dy ndeshjet e para, ka mundur Lubbock Christian 67:64 në kohën shtesë për të depërtuar në Elite Tight. Enisa është pjesë e grupmohave të Kosovës, ndërsa ka luajtur edhe me Kosovën A.

## Partizani, kampion i Ligës Unike Femrat

Partizani është kampion i Ligës Unike Femrat. Skuadra nga Tirana në finale ka mundur Flamurtarin e Vlorës me rezultat 61:72. Kjo është hera e parë që Partizani fiton Ligën Unike, ndërsa edicionin e kaluar ishte Prishtina fituese e kësaj lige. Në Final 4 e zhvilluar në Vlorë më 15 e 16 mars, Partizani në gjysmëfinale kishte mundur Bashkimin, kurse Flamurtari eliminoi Prishtinën. Hanna Brych u shpall MVP e turneut, ndërsa në pesëshen më të mirë të turneut ishin: Sarah Mgbeike e Prishtinës, Aulona Muhadri e Bashkimit, Sophia Jakobsson dhe Samra Omerbasic të Flamurtarit dhe Lasonja Edwards e Partizanit.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PRINATS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## Më 20 mars u hodh shorti për JR NBA Kosova

20 marsi ishte një ditë dhe datë e rëndësishme për Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK). Me ceremoni zyrtare është bërë hedhja e shortit për Junior NBA Kosova. Ky është edicioni i dytë i kësaj gare, ku marrin pjesë 30 shkolla fillore nga e gjithë Kosova dhe më pas janë ndarë në dy Konferenca dhe gjashtë Divizione. Hapjen e ka bërë Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, i cili ka folur për rëndësinë e këtij projekti. Ish-basketbollisti i njohur i NBA, Gordan Giricek dhe Erik Brucker kanë folur për rëndësinë e këtij programi. Më pas është hedhur shorti, ku shkollat fillore u ndanë në Divizione përkatëse. Ndërkaq ish-basketbollisti i njohur i NBA, Gordan Giricek së bashku me Erik Brucker, Menaxher i Lartë për Operacionet e NBA-së më 19 mars kanë mbajtur një stërvitje me fëmijët e Kosovës.

## Më 22 mars u mbajt Kuvendi i Punës i FBK-së

Më 22 Mars u mbajt Kuvendi i Punës i Federatës së Basketbollit të Kosovës. Në këtë Kuvend kanë marrë pjesë 31 delegatë nga 40 gjithsej sa numëron Kuvendi. Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu ka folur për të gjitha pikat e rendit të ditës, e që ishin: Raporti i Aktiviteteve të FBK-së për vitin 2022, Raporti i Auditimit për vitin 2022, Draft Plani i Veprimtimit 2023, Draft Plani Financiar 2023, Draft Plani i Marketingut 2023 dhe të ndryshme. Kuvendi ka zgjedhur si anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, Dren Zatriqin, duke zëvendësuar Artan Spahijën, me kërkesën e këtij të fundit.

## Her World, Her Rules te Kosova U20

Vashat e Kosovës U20 (25 mars) iu kanë bashkuar kampanjës "Her World, Her Rules" (Bota e Saj, Rregullat e Saj" në kuadër të projektit FIBA Europe Girls Program).

Ky program ka për synim masivizimin e basketbollit te femrat dhe mbështetjen për basketbollin femëror, ku Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku së bashku me 23 lojtare dhe stafin e Përfaqësueses së Kosovës kanë përkrahur dhe iu kanë bashkangjitur kësaj kampanje.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## Kosova në turneun e YDF-së në Bullgari

Kosova në të dyja konkurrencat me U14 mori pjesën në turneun e FIBA Europe Youth Development Fund, që u organizua në Bullgari, nga 29 marsi deri më 2 prill. Kosova në katër ndeshje pësoi katër humbje në të dyja konkurrencat, duke u mundur nga Maqedonia, Veriore, Rumania, Bullgaria dhe Turqia.

## Bashkimi kampion te femrat

Bashkimi është shpallur kampion i Kosovës në Superligën e Femrave. Prizrenaset kanë shënuar fitore në ndeshjen me Prishtinën me rezultat 78:64 apo me serinë finale 3:1 (më 11 prill). Khadija Brown Haywood është shpallur MVP. Këtë vit KBF Bashkimi ka triumfuar gjithashtu edhe në Kupën e Kosovës.

## Katër basketbolliste si Shpresa Olimpike në kuadër të KOK

Në Komitetin Olimpik të Kosovës (KOK) më 19 prill janë nënshkruar kontratat me sportistët që janë shpallur "Shpresa Olimpike 2023". Në mesin e tyre janë edhe katër basketbolliste: Etna Rexhepi, Merisa Bilalli, Olsa Tahiri dhe Yllza Uka. Basketbolli përfaqësohet më së shumti në këtë listë nga të gjitha sportet e përzgjedhura. Ato kanë nënshkruar marrëveshjen së bashku me përfaqësuesin e FBK-së, Adriatik Rraci si Menaxher i Përfaqësuesve të Kosovës. Bursistët iu takojnë 17 sporteve të ndryshme olimpike, ndërsa mbështetja për ta është në vlerë 150 euro në muaj.

## Më 25 prill "Dardanë" i mësuan emrat e ekipeve kundërshtare

Më 25 prill është hedhur shorti për Rrethin e Tretë Parakualifikues për FIBA EuroBasket 2025, ku është publikuar edhe orari. Dardanët u përcaktuan në Grupin H, së bashku me Zvicrën dhe Danimarkën. Sfidat e parë ndaj Zvicrës më 19 korrik, kurse më 26 dhe 29 korrik, Kosova ishte mysafire e Danimarkës, përkatësisht Zvicrës, kurse përballja e fundit kundër Danimarkës më 5 gusht ishte në program në Prizren.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PARTNER JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## FBK në Panairin e Turizmit dhe Sportit

Federata e Basketbollit e Kosovës ishte pjesëmarrëse në Panairin e Turizmit dhe Sportit. Ky Panair u zhvillua më 27-28 prill në Palestrën "1 Tetori" në Prishtinë. Panairin e ka vizituar edhe Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku. Në stendën e FBK-së qytetarët e shumtë janë interesuar për programet e ofruara nga Federata e Basketbollit e Kosovës, në veçanti për basketbollin 3x3. Pjesë e panairit ishin shumë organizata sportive, ekonomisë, biznesit dhe turizmit. Ky ishte edicioni i 19-të i këtij Panairi.

## Më 29 e 30 prill u mbajt Klinika e Trajnerëve me amerikanin Berlage

Më 29 dhe 30 prill në Prishtinë u mbajt Klinika e Basketbollit me trajnerin amerikan Nick Berlage. Berlage është trajner individual në NBA me përvojë 10 vjeçare. Ka punuar me 12 lojtarë të NBA dhe 39 lojtarë të NCAA divizioni 1 në përmirësimin e teknikës së gjuajtjes. Klinika u organizua nga Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (SHTBK) në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe Komunën e Prishtinës. Kjo Klinikë është vazhdimësi e SHTBK-së dhe FBK-së në edukimin e trajnerëve të basketbollit të Kosovës.

## Peja, kampione e Kosovës

Peja është shpallur kampione e Kosovës për edicionin 2022/23. Në një super finale shumë interesante dhe dramatike më 18 maj, verdhezinjtë kanë mundur Trepçën 91:93, në një të njërën nga finalet më interesante të pasluftës në basketbollin e Kosovës. Verdhezinjtë triumfuan 3:2 në serinë finale, ku sfida e fundit u zhvillua në 'Minatori' të Mitrovicës. Fundi ishte dramatik, ku Amin Hot shënoi në fund për 77:77 dhe ndeshja shkoi në vazhdimësi, e në çastet e fundit realizoi Brad Waldow për 91:93. Jalen Tate është shpallur MVP i finaleve.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PARTNER JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## Sensacionale: Arben Fetahu, zgjidhet anëtar i Bordit të FIBA Evropës

Një lajm i jashtëzakonshëm ka arritur në muajin maj nga Munihi. Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu është zgjidhur anëtar i Bordit të FIBA Evropës. Ky është një sukses i madh për Federatën e Basketbollit e Kosovës dhe basketbollin e Kosovës. Fetahu është zgjedhur me 39 vota pro në zgjedhjet që janë mbajtur më 20 maj në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Evropës, ku mori pjesë edhe Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, të cilët janë shpërblyer për punën që kanë bërë gjatë periudhës 2019-2023 në komisionet e FIBA-s.

## Fetahu zgjidhet nënkryetar i FIBA Europe Youth Commission, Dushku anëtare

Tjetër lajm madhor për Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe basketbollin e Kosovës. Pas zgjidhjes së Arben Fetahut për herë të parë anëtar i Bordit të FIBA Europës, Kryetari i FBK-së është zgjidhur edhe nënkryetar i FIBA Europe Youth Commission, ndërsa Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku është zgjidhur anëtare e FIBA Europe Youth Commission për mandatin 2023-2027. Për Dushkun ky është mandati i dytë në këtë Komision, pas atij të 2019-2023.

## Më 22 maj Rami Hadar emërohet përzgjedhës i Kosovës

Federata e Basketbollit e Kosovës më 22 maj ka prezantuar zyrtarisht përzgjedhësin e Përfaqësueses së Kosovës, Rami Hadar. Ai në edicionin 2022/23 u shpall kampion i Kosovës me Pejën, duke dëshmuar se është një trajner i nivelit të lartë, ndërsa ka përvojë të madhe në basketbollin evropian. Hadar ka mbi 30 vjet përvojë në basketbollin evropian, ku ka drejtuar skuadra të mëdha si Maccabi Haifa, Maccabi Telaviv dhe Maccabi Be'er Sheva. Për të është hera e parë që udhëheq një kombëtare A.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:







## Më 26 maj u prezantua logo e FIBA U16 Kampionatit Evropian, Divizioni C

Federata e Basketbollit e Kosovës më 26 maj ka prezantuar logon e FIBA U16 Kampionatit Evropian, Divizioni C. Inspiruar nga flamuri dhe yjet e Kosovës, logo është punuar nga FIBA për Evropianin e Divizionit C në Prishtinë. Rrathët që janë majtas dhe djathtas dhe në mes, janë pjesë e simbolit të qytetit të Prishtinës dhe Hyjneshës në fron.

## Astera Tuhina, model sukcesi para vajzave të reja

Federata e Basketbollit e Kosovës ka vazhduar me promovimin e kampanjës "Her World, Her Rules", ku së fundi si rol model për këtë kampanjë ka përzgjedhur basketbollisten e talentuar Astera Tuhina. Kampanja është organizuar në Prizren, Prishtinë dhe Pejë, në fund të muajit maj.

Së bashku me Asterën pjesë e kampanjës ishin edhe Elvira Dushku, Sekretare e Përgjithshme e FBK-së, Arben Krasniqi, Drejtor Teknik në FBK, Artina Hasani, Menaxhere e Eventeve e Basketbollit 3x3 në FBK dhe Rrezarta Kqiku, Asistente Ekzekutive në FBK. Kjo kampanjë është zhvilluar gjithashtu edhe në qytetin e Pejës për Kupën e Kosovës U16 të femrat, si dhe në Mitrovicë.

## Krasniqi prej 2 deri 4 qershor mori pjesë në Konventën e Mini Basketbollit në Madrid

Në Madrid të Spanjës është mbajtur Konventa e Mini Basketbollit, ku ka marrë pjesë edhe Drejtori Teknik në FBK, Arben Krasniqi. Konventa, që është mbajtur nga 2 deri më 4 qershor, ishte pjesë përmbyllëse e trajnimit të Kursit për trajnerë të Mini Basketbollit 2022/23 të organizuar nga FIBA Europe.

## Prej 8 deri 12 qershor u mbajt turneu i YDF-së në Prizren

Nga 8 deri më 12 qershor në Prizren është organizuar turneu i FIBA YDF-së për U14. Në këtë turne kanë marrë pjesë: Kosova, Maqedonia Veriore, Turqia, Bullgaria dhe Rumania në të dyja konkurrencat. Për pesë ditë me radhë janë

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





zhvilluar 20 ndeshje. FBK dhe FIBA YDF kanë bashkëpunim që nga viti 2016, bashkëpunim ky, i cili ka ndihmuar në zbulimin e talenteve të rinj, edukimin e trajnerëve dhe ngritjen profesionale të lojtarët.

## Hajdari pjesë e FIBA Foundation European Youth Leadership Program

Këshilltarja Ligjore për Sport në FBK, Enea Hajdari ka marrë pjesë në programin FIBA Foundation European Youth Leadership Program. Punëtorja në kuadër të këtij programi u zhvillua në Gjenevë, nga 14 dhe deri më 18 qershor. Gjatë kësaj punëtorie Hajdari gjithashtu ishte pjesë e organizimit të FIBA Open, turneut 3x3 ndër më të mëdhenjtë në Zvicër.

## Kosova e gatshme për eventet prestigjioze të FIBA 3x3

Në organizim të klubit 3x3 Prishtina më 15 qershor është mbajtur konferenca për media kushtuar eventit madhështor të basketbollit 3x3, FIBA 3x3 Women's Series&FIBA 3x3 Challenger Prishtina, si dhe organizimit të FIBA 3x3 U23 Nations League nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK).

Numri një i FBK-së, Arben Fetahu tha se është shumë i kënaqur me gjithë këtë përkrahje që e ka dhe do të vazhdoj ta ketë basketbolli dhe basketbolli 3x3.

Në konferencë është lansuar edhe zyrtarisht fanella unike e eventit, si dhe detaje të tjera shtesë rreth këtij eventit madhështor.

## Ekipi Bar-Bon fitues i Prizren Edition 3x3

Më 18 qershor është zhvilluar turneu Prizren Edition 3x3 në organizim të klubit 3x3 Prishtina, Komunës së Prizrenit dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Përgjatë gjithë ditës ishte një atmosferë fantastike në Prizren, më saktësisht tek shatërvani, ku një numër i madh i adhuruesve të basketbollit ishin të pranishëm në ndeshjet në të cilat rivaliteti ishte shumë i madh, por edhe patëm rastin të shohim basketboll mjaft atraktiv. Ekipi fitues i Prizren Edition është Bar-Bon nga Prizreni pasi në finale triumfoi ndaj ekipit të Prishtinës.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PRIZREN JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## Kosova 3x3 më 17 e 18 qershor mori pjesë në kualifikimet e FIBA Europe Cup në 3x3

Më 17/18 qershor u zhvilluan kualifikimet në FIBA Europe Cup në 3x3, ku Kosova u përfaqësua nga ekipi i meshkujve dhe femrave.

Dardanët kanë pësuar nga Irlanda, Andorra dhe Shqipëria, kurse Dardanet në grupe kishin një fitore (ndaj Andorrës 16:18) dhe dy humbje (nga Luksemburgu 4:17 dhe Qipro 20:9). Ndërkohë, në sfidën e fundit pësuan nga Irlanda 16:4.

## Dushku ishte pjesë e panelit "Women in Leadership Forum"

Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku më 23 qershor në Lubjanë ishte pjesë e panelit "Women in Leadership Forum" me ftesë të FIBA (Federata Ndërkombëtare e Basketbollit).

Para pjesëmarrjes në panel të Forumit, Dushku ka pasur rastin që të ndajë rrugëtimin e saj në cilësinë e Sekretares së Përgjithshme, që nga emërimi në vitin 2017 (si u.d.) e deri më tani, me pjesëmarrëset e programit WiLEAD.

## Rexha përfundon me sukses FIBA Programin "Eurostep"

Menaxheri për Media në FBK, Bahri Rexha ka përfunduar me sukses programin e FIBA-s për media "Eurostep", që u organizua më 20-21 qershor në Lubjanë. Workshopi u organizua në Lubjanë të Sllovenisë, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të Federatave Nacionale të Basketbollit dhe klubeve në Evropë, ndërsa FBK-ja u përfaqësua nga Rexha.

## Kajashi dhe Kqiku diplomojnë me sukses në Programin WiLEAD

Menaxherja e Financave në FBK, Nadire Kajashi dhe Asistentja Ekzekutive, Rrezarta Kqiku kanë diplomuar me sukses në Programin e FIBA Evropës, Gratë në Lidërsip (WiLEAD). Kajashi është prezantuar me temën: "Rritja e numrit të vajzave e grave në basketboll", ndërsa Kqiku me temën: "Rritja e numrit të

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





tifozëve që janë prezentë në ndeshjet e basketbollit të femrave". Programi u zhvillua më 23-24 qershor në Lubjanë të Sllovenisë.

## Vëllaznimi fitoi Kupën te Veteranët

Më 25 qershor, basketbollistët veteranë të Vëllaznimit, duke triumfuar ndaj Bashkimit në finale të Kupës së Kosovës për veteranë kanë fituar trofeun e parë të Ligës së Veteranëve të Kosovës, në sezonin e parë të organizimit të saj.

Gjakovarët ishin më të mirë se prizrenasit gjatë gjithë ndeshjes dhe në fund fituan me rezultat 42-30, ndërsa pjesa e parë kishte përfunduar 22-15 në të mirë të Vëllaznimit. Bashkimi mori vendin e dytë në Final Four të Kupës së Kosovës për veteranë, ndërsa më parë në gjysmëfinale kishin fituar Pejën 43-38, kurse Vëllaznimi Prishtinën 48-35.

## FBK filloi me implementimin e projektit "PROMISE"

Federata e Basketbollit e Kosovës për herë të parë është bërë pjesë e një projekti të Bashkimit Evropian, më saktësisht në kuadër të programit të Erasmus+. Projekti i fituar është PROMISE (Një Hap Përpara për Basketbollin e Vajzave dhe Grave). Objektivi i përgjithshëm i projektit "PROMISE" është të promovojë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në basketboll në të gjitha nivelet e përgjegjësiwepërmjet hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të një programi gjithëpërfshirës të ndërhyrjes. Projekti "PROMISE" ka filluar në Janar 2023 dhe do të përfundojë në Qershor 2025.

## Kosova A me 2 fitore e 2 humbje

Kosova kishte dy fitore e dy humbje në parakualifikimet për FIBA Eurobasket 2025. Dardanët e nisën me fitore, duke mundur Zvicrën 76:49, në sfidën e zhvilluar në Prizren. Më pas pësuan nga Danimarka 82:75, kurse në Fribourg erdhi një fitore e ëmbël dhe shumë e dashur ndaj Zvicrës 72:76, ku tifozët shqiptarë i dhanë përkrahje të madhe. Në ndeshjen vendimtare, Dardanët pësuan nga Danimarka 63:88 dhe nuk arritën kualifikimin tutje.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP PARTNER JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## Kosova U20M renditet e 11-ta

Kosova U20 është renditur në vendin e 11- të në Kampionatin Evropian, Divizioni B, që u mbajt në Shkup të Maqedonisë Veriore.

### Rezultatet

Kosova-Gjeorgjia 70:80, Suedia-Kosova 84:76, Kosova-Azerbajxhani 75:71, Ukraina-Kosova 78:62, Letonia-Kosova 78:81, Bullgaria-Kosova 115:80, Kosova-Austria 78:67.

## Kosova U20 (F) garoi në Rumani

Kosova U20 në konkurrencën e femrave mori pjesë në Kampionatin Evropian, Divizioni B, në Craiova të Rumanisë.

### Rezultatet

Holanda-Kosova 87:57, Kroacia-Kosova 43:85, Sllovenia-Kosova 79:49, Sllovakia-Kosova 93:32, Kosova-Bullgaria 62:80, Kosova-Austria 50:83.

## Kosova U18 (M) garoi në Portugali

Kosova U18 (M) mori pjesë në Kampionatin Evropian, Divizioni B që u mbajt në Portugali.

### Rezultatet

Kosova-Estonia 60:68, Holanda-Kosova 82:67, Kosova-Rumania 64:98, Irlanda-Kosova 77:70, Kosova-Rumania 68:78, Kosova-Zvicra 84:85, Shqipëria-Kosova 64:85.

## Vashat e Kosovës U18 të gjashtat në Shqipëri

Kosova U18 është renditur në vendin e gjashtë në Kampionatin Evropian, Divizioni C në Durrës të Shqipërisë.

### Rezultatet

Kosova-Shqipëria 45:63, Armenia-Kosova 73:48, Moldavia-Kosova 61:85, Qipro-Kosova 85:54.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## Mustafa dhe Zeka në FIBA European Women's Basketball Summit

Arta Mustafa si trajnere dhe Jeta Zeka si gjyqtare kanë marrë pjesë në FIBA European Women's Basketball Summit (Samiti Evropian i Basketbollit të Vajzave).

Kjo ngjarje u zhvillua më 5-9 korrik në Postojna të Sllovenisë. Arta dhe Jeta janë deleguar nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), që vazhdon të investojë në kuadro, sidomos në trajnere dhe gjyqtare. Ky event ofron trajnime për lojtaret, trajneret dhe gjyqtaret e basketbollit.

## Për herë të parë në Kosovë organizohet FIBA 3x3 U23 Nations League

Nga 10 deri më 12 korrik në kryeqytetin e Kosovës është mbajtur për herë të parë në vendin tonë, turneu i FIBA 3x3 U23 Nations League. Gjithashtu kjo ishte hera e parë që Kosova U23 mori pjesë në këtë garë në të dyja konkurrencat. Gjithsej morën pjesë gjashtë shtete të femrat dhe gjashtë të meshkujt, ku në qendër të Prishtinës u zhvilluan ndeshje shumë të mira dhe cilësore, ndërsa në fund të ditës u zhvillua edhe finalja të meshkujt dhe femrat. Shtetet pjesëmarrëse ishin Kosova, Gjermania, Turqia, Greqia, Hungaria dhe Holanda.

## Spektakli i basketbollit 3x3 vazhdoi me FIBA 3x3 Women's Series dhe FIBA 3x3 Challenger Prishtina

Sërish në qendër të Prishtinës u organizua një turne ndërkombëtar i 3x3, kësaj radhe FIBA 3x3 Women's Series dhe FIBA 3x3 Challenger Prishtina, ku FBK ishte bashkë organizatore e kësaj ngjarje, kurse organizatore është klubi Prishtina 3x3. Eventu u organizua nga 14 deri më 16 korrik. 14 shtete morën pjesë në FIBA Women's Series, kurse për Kosovën që debutoi garuan Saranda Daci, Enisa Kamerolli, Agnesa Rrahmani dhe Sara Vraniqi. SHBA triumfoi te kjo garë, ndërsa Amsterdam te meshkujt. Te meshkujt morën pjesë ekipe nga mbarë bota, ndërsa nga Kosova ishte BarBon i Prizrenit.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## Spaqi diplomi me sukses në FIBA Europe Coaching Certificate

Ky program ka filluar më 2021, ku Spaqi është përzgjedhur nga Federata e Basketbollit e Kosovës. Gjatë tri viteve trajnerët kanë ndjekur Programe të ndryshme zhvillimore për gjeneratat e reja. Spaqi së bashku me trajnerët tjerë ka ndjekur Kampionatin Evropian U16 në Shkup, Kampionatin Evropian U18 në Izmir të Turqisë dhe Kampionatin Evropian U20 në Kretë të Greqisë. Këto i ka ndjekur gjatë tri viteve, ku ka parë mundësinë të shohë punën që bëhet me gjenerata të reja, por edhe njëkohësisht të analizojë ndeshjet e garave evropiane.

## Prej 18 deri më 23 korrik u mbajt Kampi Nacional i FBK-së

Nga 18 deri më 23 korrik është mbajtur Kampi Nacional i Federatës së Basketbollit të Kosovës. Në këtë Kamp kanë marrë pjesë fëmijët e gjeneratës së lindur më 2010-2011, në të dyja konkurrencat, ndërsa janë vëzhguar nga trajnerët/et gjatë gjithë kohës. Synimi i këtij kampi është zhvillimi i gjeneratave të reja, që më vonë do të jenë pjesë e Përfaqësuesve të Kosovës dhe do të jenë e ardhmja e basketbollit.

## Edhe një Evropian me sukses u zhvillua në Prishtinë

Nga 19 deri më 27 korrik është mbajtur Kampionati Evropian, Divizioni C për meshkuj U16. Në këtë Evropian kanë marrë pjesë nëntë shtete, ndërsa të gjitha ndeshjet janë zhvilluar në palestrën "1 Tetori" në Prishtinë, ndërsa interesimi ishte i kënaqshëm për këtë Evropian. Federatës së Basketbollit të Kosovës iu nda çmimi për organizimin e eventit, ku çmimin e pranoi Drejtori Teknik në FBK, Arben Krasniqi. Qipro u shpall kampione, ndërsa MVP u shpall basketbollisti i Qipros, Demir Oztoprak. Lis Binishi hyri në Top 5.

## Drejtori Ekzekutiv i FIBA Europe, Kamil Novak vizitoi Kosovën

Drejtori Ekzekutiv i FIBA Evropës, Kamil Novak, më 19 korrik ka vizituar Kosovën. Novak është takuar me drejtuesit e FBK-së, ndërsa më pas i shoqëruar nga Kryetari Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku kanë vizituar Komitetin Olimpik të Kosovës. Novak vlerësoi lart punën dhe

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





përkushtimin e FBK-së për avancimin e basketbollit, derisa përmendi organizimet e shumta ndërkombëtare që po i bënë federata, si dhe shprehu konsideratën e lart edhe për emërimin e Fetahut, anëtar i Bordit të FIBA Evropës. Novak ishte i pranishëm në ndeshjen e Kampionatit Evropian, Divizioni C për meshkuj U16 mes Kosovës dhe Maltës, e më pas Kosova A me Zvicrën.

## FBK me 4 FIBA Gjyqtarë për periudhën 2023-2025

Federata e Basketbollit e Kosovës (më 14 gusht) është njoftuar nga Sekretari i Përgjithshëm i FIBA-s, Andreas Zagklis me vendimin e Komisionit Teknik të FIBA-s për licencimin e gjyqtarëve dhe të Komisionerit të FBK-së për Periudhën e Licencimit FIBA GOL 2023-2025. Sipas rregulloreve të brendshme të FIBA-s, Licenca për FIBA gjyqtarët është e vlefshme për periudhë dyvjeçare, duke filluar nga 1 shtatori 2023 dhe skadon më 31 gusht 2025. Licenca për FIBA gjyqtarë i janë ndarë gjyqtarëve Xhelal Mumini, Ngadhnjim Shabani, Eldin Uglari, Amar Djekovic, si dhe për FIBA Komisionerin, Faton Kurshumlija.

## Dushku e përfaqësoi FBK-në në Kongresin e FIBA-s në Manila

Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku e ka përfaqësuar FBK-në në Kongresin e FIBA-s, që është mbajtur në Manila më 23 e 24 gusht, ku është zgjedhur Presidenti dhe Bordi Qendror i ri i FIBA-s. Krahas Kongresit Dushku ka marrë pjesë edhe në hapjen solemne të Botërorit, që është organizuar më 25 gusht në Manila me një atmosferë të paharruar. Dushku ishte edhe pjesë e Punëtorive të organizuara nga FIBA në kuadër të Kongresit me temat: Vajzat dhe Gratë në Basketboll, Integriteti në Basketboll dhe Përgatitja e Planeve Strategjike për Federatat Nacionale.

## Prej 21 deri më 25 gusht u mbajt Kampi nga Kosovo Basketball Heritage Academy

Prej 21 deri më 25 gusht është mbajtur me sukses kampi i basketbollit për moshat 8-16 vjeç në katër qytete të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Gjakovë. Ky Kamp është organizuar nga Kosovo Basketball Heritage Academy dhe Federata e Basketbollit e Kosovës. Pasi është mbajtur në katër qytetet e

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:







FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr.83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

Kosovës, më 25 gusht në kryeqytetin e Kosovës është zhvilluar edhe All Star final njëditor, ku janë shpallur MVP në të dyja konkurrencat. Në kamp kanë punuar Edona Thaqi, Brian S. Kriftcher, Sarah Kustok dhe Falecia Cabral Porter. Kampi është vëzhguar nga Arben Krasniqi, Drejtor Teknik në Federatën e Basketbollit të Kosovës.

## Etna Rexhepi në Basketball Without Borders European Camp

Basketbollistja e re Etna Rexhepi ishte pjesë e Basketball Without Borders European Camp. Ky kamp u mbajt prej 23 deri më 29 gusht në Wrocław të Polonisë. Basketball Without Borders është kamp elitare për zhvillimin e shkathtësive individuale të lojtareve të talentuara të regionit. Etna është zgjedhur në mënyrë individuale nga NBA dhe FIBA, duke u bazuar në shkathtësitë e saj si lojtare e jashtëzakonshme. Kjo ishte hera e parë që një basketbolliste nga Kosova ftohet në një kamp të tillë. Ajo fitoi çmimin Sportsmanship Award në këtë Kamp.

## Obërtinca në Programin FECC

Driton Obërtinca ka marrë pjesë (në fund të gushtit) në programin FECC (FIBA Europe Coaching Certificate) në Klinikën që u zhvillua në Shkup të Maqedonisë Veriore. Ky program është për një periudhë trevjeçare, ndërsa Obërtinca, i cili është përzgjedhur nga FBK, ndoqi nga afër Klinikën në Shkup, ku u zhvillua edhe Kampionati Evropian, Divizioni A për meshkuj U16. Qëllimi i organizimit të klinikave në përpunje me Kampionatin Evropian për meshkuj U16, U18 dhe U20 është për të monitoruar zhvillimin e lojtarëve të rinj nga mosha 15 deri në 20 vjeç gjatë një periudhe prej dy deri në tre vjet në garat kryesore.

## Kosova 3x3 për herë të parë në Lojërat Mesdhetare në Rërë "Heraklion 2023"

Nga 9 deri më 16 shtator janë mbajtur Lojërat Mesdhetare në Rërë "Heraklion 2023". Për herë të parë Kosova ka garuar në 3x3, te meshkujt dhe femrat. Kosova te meshkujt ishte në grup me Greqinë, Kroacinë dhe Maqedoninë

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





Veriore, kurse femrat me Tunizinë dhe Kroacinë. Kosova 3x3 (M) mundi Maqedoninë Veriore 14:12. Në përgjithësi kanë marrë pjesë 26 shtete me 13 sporte të ndryshme. 765 sportistë ishin me 1131 pjesëmarrës në përgjithësi.

## **FBK për herë të parë me përfaqësues në një Komision të FIBA Botës, Dushku emërohet anëtare e Komisionit të FIBA 3x3**

Federata e Basketbollit e Kosovës për herë të parë do ta ketë një përfaqësues në një Komision të FIBA Botës. Bëhet fjalë për emërimin e Sekretares së Përgjithshme të FBK-së, Elvira Dushku në Komisionin e FIBA 3x3 nga Bordi Qendror i FIBA-s. Emërimi i Dushkut sipas Bordit Qendror të FIBA-s ka ardhur si rrjedhojë e aftësive, përvojës dhe angazhimit të saj për zhvillimin e basketbollit. Mandati i Dushkut në FIBA Komisionin 3x3 është katërvjeçar (4) 2023-2027.

## **Klinikë për trajnerët, ligjëruan Bradley Soderberg dhe Luca Palumbo**

Shoqata e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK) ka organizuar Klinikën për Trajnerë të Basketbollit më 9 dhe 10 Shtator.

Ligjërues në këtë Klinikë ishin trajnerët e mirënjohur: Bradley Soderberg, trajner në Universitetin e Virginia të SHBA dhe Luca Palumbo trajner në Orange1 Basket Academy.

## **Më 14/15 shtator Dushku dhe Medunjanin në Lisbonë për programin PROMISE**

Në Lisbonë të Portugalisë më 14/15 shtator janë mbledhur Partneret e Projektit PROMISE dhe ekspertet ndërkombëtare. Në këtë event kanë marrë pjesë edhe Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe Menaxherja e Projekteve në FBK, Edita Medunjanin. Qëllimi i këtij takimi ishte të diskutohen rezultatet e hulumtimit, strategjia dhe metodologjia e Pilot Programit PROMISE. Projekti PROMISE do të trajtojë çështjen e mungesës së barazisë gjinore në basketboll përmes aktiviteteve të ndryshme dhe zhvillimit të mjeteve që do të nxisin pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në sport në të gjitha nivelet.

### **Kosovo Basketball Federation**

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## Trepça triumfoi në Superkupë

Trepça është fituese e Superkupës së Kosovës në basketboll. Mitrovicasit në finale kanë mundur Pejën me rezultat 78:76. Finalja u zhvillua më 17 shtator.

Kevin Davis u shpall MVP i turneut, çmim të cilin ia dorëzoi Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ndërsa trofeun kapitenit të Trepçës, Valdrin Haxhiu ia dorëzoi Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu.

Në këtë garë morën pjesë tetë skuadrat e elitës së basketbollit. Superliga e Meshkujve u zhvillua nga 13 deri 17 shtator.

## Hasani, pjesëmarrëse në Programin S2ABC Project për Administratën Sportive

Menaxherja e Eventeve në FBK, Artina Hasan ka qenë pjesëmarrëse në programin "S2ABC Project" për administratën sportive. Ky program u organizua më 20-22 shtator. Modulet e këtij Programi ishin online, ndërsa Kursi pas Brukselit do të vazhdojë edhe në tremujorin e parë të vitit 2024. Diplomimi do të mbahet në Kosovë. Tri modelet kryesore janë: Menaxhimi i projektit, financa dhe burimet njerëzore.

## Bashkimi triumfon në Superkupën e Femrave

Skuadra e Bashkimit triumfoi në Superkupën e Femrave. Në finalen e zhvilluar në Prizren ka triumfuar ndaj Prishtinës me rezultat 49:57 (16:13, 9:9, 11:16, 13:19). Ndashje ishte interesante nga fillimi deri në fund, me shumë kthesa dhe dramë në fund. MVP e turneut është shpallur Sarah Mgbeike, çmim të cilin ia ka dorëzuar anëtarja e Bordit të FBK-së, Teuta Abdullahu, ndërsa trofeun për kapitenin e Bashkimit, Aulona Muhadri ia dorëzoi Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu.

Në finalen e Superkupës janë pensionuar dy basketbollistet shumë të trofeshme dhe të cilat ishin pjesë e Përfaqësueses A të Kosovës, Ulpiana Emra dhe Irma Konjusha. Pensionimi i basketbollisteve Emra dhe Konjusha u bë me ceremoni zyrtare të përgatitur nga Federata e Basketbollit të Kosovës në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë në basketbollin e Kosovës. Emra dhe Konjusha janë ndër basketbollistet më të trofeshme në Kosovë, të cilat kanë

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr.83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

arritur të fitojnë shumë trofe, si dhe janë stolisur me medaljen e bronzë në Kampionatin e Shteteve të Vogla në vitin 2021, ku kanë përfaqësuar Kosovën A.

## Medunjanin dhe Hajdari, pjesë e Programit "Future Leaders in Football"

Menaxherja e Projekteve në FBK, Edita Medunjanin dhe Këshilltarja Ligjore për Sport, Enea Hajdari janë pjesë e Programit "Future Leaders in Football". Qëllimi i këtij Programi ishte zhvillimi i aftësive për të trajtuar Sfidat në Sport dhe Shoqëri. Ky program është mbajtur prej 1 deri më 7 tetor në Durrës.

## FBK fituese e projektit "SAFEGUARDING THE FUTURE" në Erasmus +

Federata e Basketbollit e Kosovë është njoftuar nga zyra e Erasmus + se është fituese e projektit SAFEGUARDING THE FUTURE, në të cilin projekt FBK është koordinatore, përderisa partnere të saj në janë Federata e Basketbollit të Estonisë, Federata e Basketbollit të Bullgarisë dhe Shoqatën e Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës (SHTBK). SAFEGUARDING THE FUTURE është një projekt që synon të krijojë mekanizma në Kosovë, Estoni dhe Bullgari që sigurojnë një përvojë basketbolli të sigurt, pozitive dhe argëtuese për të gjithë njerëzit e përfshirë në basketboll, me theks të veçantë tek fëmijët dhe të rinjtë. Qëllimi kryesor i projektit është të ndërmarrë veprime për të mbrojtur njerëzit nga çdo lloj abuzimi në basketboll. Për ta bërë këtë, projekti do të krijojë sisteme mbrojtëse për të gjitha federatat kombëtare të basketbollit, në Kosovë, Estoni dhe Bullgari. Ky projekt do të zgjasë 18 muaj, duke filluar nga janari 2024 deri në qershor 2025.

## Krasniqi merr pjesë në Seminarin për Shëndetin Mental

Më 10 tetor për Ditën Botërore të Shëndetit Mental, Komiteti Olimpik i Kosovës ka organizuar seminarin e dytë për shëndetin mental në sport. Në këtë Seminar kanë marrë pjesë 40 trajnerë të federatave të ndryshme sportive. Nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka marrë pjesë Drejtori Teknik në FBK dhe trajneri i njohur dhe i trofeshëm, Arben Krasniqi.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## Fetahu dhe Dushku në Munih për takim e FIBA Europe Youth Commission

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku më 24 mars kanë marr pjesë në takimin e parë të FIBA Europe Youth Commission për mandatin 2023-2027. Kryetari Fetahu është nënkryetar i këtij komisioni, ndërsa Dushku është anëtare e Komisionit. Për Sekretaren e Përgjithshme të FBK-së ky është mandati i saj i dytë si anëtare e këtij komisioni, ndërsa për Fetahun kjo është hera e parë. FIBA Europe Youth Commission është një nga komisionet më të rëndësishme dhe më aktive të FIBA Evropës. Takimi i Komisionit është zhvilluar në Munih të Gjermanisë.

## Robaj dhe Hashani në FIBA Europe U14 Get-Together 2023

Trajnerja dhe trajneri me perspektiv, Agnesa Robaj dhe Dëfrim Hashani kanë marr pjesë në Klinikën e FIBA Europe U14 Get-Together 2023. Klinika është mbajtur më 27-29 tetor në Estoril të Portugalisë. Robaj dhe Hashani janë nominuar nga Federata e Basketbollit e Kosovës dhe së fundi e kanë përfunduar Kursin Teknik të FIBA-s që organizohet nga FBK në bashkëpunim me FIBA-n dhe Komitetin Olimpik të Kosovës.

## Kosova organizatore e FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier

Për herë të parë në vendin tonë nga Federata e Basketbollit e Kosovës do të organizohet FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier 2024-2025. Ky organizim i është besuar FBK-së nga FIBA dhe FIBA 3x3, ku të gjitha palët e përfshira së fundi kanë nënshkruar një kontratë dyvjeçare me mundësi vazhdimi edhe për dy vite të tjera. FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier është një garë zyrtare në nivel të kombëtareve në të cilën marrin pjesë ekipet nacionale nga Federatat anëtare kombëtare të FIBA-s. Formati i ngjarjes: Dy ditë (08/09 qershor 2024)/Dy konkurrencat (meshkuj/femra) në Prishtinë. FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier shërben si turne kualifikues për të siguruar një vend në FIBA 3x3 Europe Cup,

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BP PRINCEPS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





pra fituesit e FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier 2024 kualifikohen direkt në FIBA 3x3 Europe Cup të po njëjtit vit.

## **Braha mori pjesë në Punëtorinë e dytë për SPOC Personat në Athinë**

Vlora Braha, Zyrtare për Integritet (SPOC) në Federatën e Basketbollit të Kosovës ka marrë pjesë në Punëtorinë e FIBA-s për SPOC personat. Kjo është Punëtorja e dytë që mbahet për SPOC personat, derisa e para ishte organizuar në Munihi të Gjermanisë. Punëtorja është mbajtur 2 dhe 3 nëntor në Athinë të Greqisë. Në këtë Punëtori kanë marr pjesë përfaqësues nga Federatat Evropiane dhe Botërore.

## **Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit për Programin "Sport në Shkolla"**

Më 13 nëntor është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit për Programin "Sport në Shkolla" ndërmjet Federatës së Sportit Shkollor të Kosovës, Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Federatës së Shahut të Kosovës. Qëllimi i këtij Memorandumi është thellimi i bashkëpunimit ndërmjet Federatave rreth implementimit të programit 'Sport në Shkolla', program ky i mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Qëllimet kryesore të programit 'Sport në Shkolla' janë: Inkuadrimi dhe praktikimi i sportit të basketbollit 3x3 dhe atij të shahut në shkollat publike si aktivitet ekstrakurrikular; Organizimi i garave; Promovimi i vlerave sportive dhe trajtimi i çështjeve sociale përmes sportit; dhe Ngritja e kapaciteteve njerëzore në fushën e edukimit dhe sportit

## **Prezantohet Programi shtetëror "Sport në Shkolla"**

Ministria e Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe me Federatat Sportive ka hartuar programin "Sport në Shkolla" përmes së cilit po krijohet mundësia që të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar në Kosovë të jenë pjesëmarrës të rregullt në sport dhe aktivitete fizike. Pjesë e këtij programi është edhe Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) me basketbollin 3x3. Në prezantimin e Programit kanë marrë pjesë edhe Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe Menaxherja e Projekteve, Edita Medunjanin.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANCE JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





## Shpallja e Laureatëve më 21 dhjetor, emërohen edhe përzgjedhësit e grupmoshave të reja

Më 21 nëntor, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës ka emëruar trajnerët dhe ndihmëstrajnerët e Përfaqësueseve të Reja të Kosovës (U16M, U16F, U18M, U20M). **Te Kosova U16 Meshkujt** përzgjedhës do të jetë Dion Pllana, ndërsa ndihmëstrajner Dëfrim Hashani. **Te Kosova U16 Femrat** përzgjedhës do të jetë Hasan Bytyqi dhe ndihmëstrajner Melda Baliqi. **Te Kosova U18 Meshkujt** përzgjedhës do të jetë Brahim Veseli dhe ndihmëstrajnerët Elbesar Gështenja dhe Hekuran Husaj. **Kosova U20 Meshkujt** do të vazhdohet të drejtohet nga Dritëro Sefaja me ndihmëstrajner Safet Kastrati.

## Peja luftoi deri në fund, por nuk arriti kualifikimin nga grupet e FIBA Europe Cup

Peja garoi në grupet e FIBA Europe Cup, ku edhe pse ishte afër, nuk arriti kualifikimin. Verdhezinjtë e mbyllën aventurën në FIBA Europe Cup me dy fitore e katër humbje, duke u renditur në vendin e tretë të Grupit H, me shtatë pikë, Spojnia Stargard ishte e dyta me 9 pikë, ndërsa skuadra gjermane, Chemnitz lidere e grupit me 12 pikë, duke shënuar të gjitha fitore. Heroes Den Bosch mbeti e fundit me shtatë pikë. Kampionët e Kosovës shënuan fitore ndaj Heroes Den Bosch me rezultat 99:84, si dhe kundër Spojnia Stargard 79:83. Ndërkaq para garave në FIBA Europe Cup, Peja ka pësuar humbje nga kampioni i Danimarkës, Bakken me rezultat 103:79, në takimin e zhvilluar në Antalia të Turqisë, në çerekfinale të kualifikimeve për Basketball Champions League.

## Trepça për herë të parë në grupet e FIBA Europe Cup

Fituesja e Kupës dhe Superkupës së Kosovës për herë të parë mori pjesë në grupet e FIBA Europe Cup. Mitrovicasit ishin në grup me BCM Gravelines Dunkerque, ZZ Leiden, si dhe Hapoel Galil Elion. Kjo e fundit u tërhoq nga garat për shkak të situatës në Lindjen e Mesme. 'Xehetarët' kishin katër ndeshje në grup, ku shënuan një fitore, BCM Gravelines Dunkerque, 76:68 dhe tri humbje, ku nuk arritën kualifikimin tutje.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



BIP FINANS JOINT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr.83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

Paraprakisht në kualifikimet për grupet e FIBA Europe Cup, kishin triumfuar në Estoni, ndaj Tindastoll dhe Parnu Sadam.

## **Kosova organizatore e FIBA Kampionatit Evropian për Shtete të Vogla – Femrat dhe FIBA U18 Kampionatin Evropian, Divizioni C – Femrat**

Bordi i FIBA Evropës në mbledhjen e mbajtur në Gjenevë ka vendosur që t'ia besoj Federatës së Basketbollit të Kosovës organizimin e dy eventeve madhështore si: FIBA Kampionati Evropian për Shtete të Vogla – Femrat dhe FIBA U18 Kampionati Evropian, Divizioni C – Femrat. Gara e parë do të mbahet më 25-30 qershor, kurse e dyta më 23-28 korrik. Në mbledhjen e Bordit të FIBA Evropës, ku mori pjesë edhe Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu si anëtar i Bordit, u përcaktuan edhe shtetet e tjera organizatore të Kampionateve Evropiane, ku kështu Kosova do të marrë pjesë me U20 të meshkujt në Divizionin B, që zhvillohet në Rumani nga 12 deri më 21 korrik; Kosova me U18 meshkujt do të garojë në Divizionin B, që zhvillohet në Maqedoninë Veriore, nga 26 korriku deri më 4 gusht; Kosova U16 meshkujt do të luajë në Durrës, në Divizionin C nga 9 deri më 14 korrik; Kosova U16 të femrat do të garojë në Divizionin B, ku Turqia pritet të konfirmohet si organizatore, nga 15 deri më 24 gusht.

### **Më 25 nëntor u mbajt Klinika për basketbollin 3x3**

Më 25 nëntor është mbajtur Klinika e Basketbollit 3x3 ku ka ligjëruar eksperti ndërkombëtar, Jaume Comas. Klinika ka qenë për Arsimitarët/et të cilët do të angazhohen në cilësinë e trajnerit/es për fëmijët në Programin "Sport në Shkollë", pjesë e të cilit është edhe Federata e Basketbollit të Kosovës me basketbollin 3x3.

Ky Program është hartuar nga Ministria e Sportit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe me Federatën e Sportit Shkollor të Kosovës. Pjesë e këtij Programi janë Federata e Sportit Shkollor të Kosovës, Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) dhe Federata e Shahut të Kosovës.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:







## 2024 vjen në Kosovë me eventet më të mëdha të basketbollit 3x3

Fillimisht, në datat 08-09 qershor, Prishtina do të jetë nikoqire e FIBA 3x3 Europe Cup Qualifier, një garë kjo e rëndësishme e disiplinës 3x3, ku 15 shtete në të dyja konkurrencat do t'i matin forcat për të siguruar një vend në FIBA 3x3 Europe Cup.

Ndërkaq më 18 dhe 19 korrik, klubi 3x3 Prishtina në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit të Kosovës, Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport dhe Komunën e Prishtinës do të jetë nikoqire e FIBA 3x3 Women's Series, kurse prej 20 deri më 21 korrik do të organizohet një tjetër event prestigjioz si FIBA 3x3 Challenger Prishtina.

## Rraci përfundon me sukses Programin FIBA Players Mentorship

Menaxheri i Përfaqësuesëve të Kosovës, Adriatik Rraci ka përfunduar me sukses FIBA Players Mentorship Program. Rraci, këtë Program e ka ndjekur përmes ligjëratave online, të cilat janë zhvilluar gjatë muajit Tetor 2022 dhe muajit Mars 2023. Për ta përfunduar këtë Program duhet kompletuar të gjitha fazat, siç janë: Athlete Lifestyle Mentor Certificate, FIBA Off - Court Guide, Individual Assignment. Menaxheri i Përfaqësuesëve të Kosovës ka përfunduar me sukses të gjitha detyrat e kërkuara dhe në fund ka diplomuar me sukses.

## Braha nominohet në ndeshje të FIBA EuroBasket 2025 Qualifiers

Vlora Braha është nominuar si ndihmëse e Delegatit Teknik në ndeshjen Italia-Turqia, e vlershme për FIBA EuroBasket 2025 Qualifiers. Ky është nominimi i parë të cilin Federata e Basketbollit e Kosovës e pranon në këtë kompeticion. Braha paraprakisht ka përfunduar me sukses të gjitha testet, si dhe ka ndjekur Punëtoritë që janë zhvilluar nga FIBA.

Kjo është dëshmi që, FBK është e vendosur në masivizimin e grave në basketboll. Delegimi i ish-basketbollistes së njohur në Kualifikimet e FIBA EuroBasket 2025 është e arritur shumë e madhe për vetë Brahën, por edhe për FBK-në, si dhe për gratë në përgjithësi.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





## Bushati pritet nga krerët e FBK-së, dakordohen për Ligën Unike

Krerët e Federatës së Basketbollit të Kosovës kanë pritur Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës Shqiptare të Basketbollit (FSHB), Franko Bushati, i cili sapo është emëruar në këtë pozitë, ndërsa ishte i shoqëruar nga Ersi Oruci, përgjegjës për Ligën Unike në FSHB. Bushati dhe Oruci janë pritur në FBK nga numri një i FBK-se, Arben Fetahu, Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku dhe Menaxheri i Përfaqësueseve, Adriatik Rraci. Bushati ka një karrierë të pasur sportive, duke qenë basketbollist i Kombëtares shqiptare për shumë vite, si dhe ka luajtur në elitën e basketbollit të Italisë, si dhe në shumë skuadra italiane, ku ka një përvojë të gjatë në basketboll.

Kryetari Fetahu e ka uruar Bushatin për pozitën e re në FSHB, duke i uruar suksese, si dhe bashkëpunim maksimal në zhvillimin e basketbollit në Shqipëri. Krerët e FBK-së dhe Bushati kanë folur për projektet e përbashkëta, me theks të veçantë vazhdimin e projektit të Ligës Unike.

## Kurshumlja dhe Mumini në Play-off të FIBA Euro Cup Women

Pas paraqitjeve shumë të suksesshme në garat evropiane, Komesari i Garave të FBK-së, Faton Kurshumlja dhe gjyqtari Xhelal Mumini sërish janë deleguar për FIBA Euro Cup Women. Kurshumlja dhe Mumini janë nominuar në ndeshjet e Top 16 apo "Play-off" të FIBA EuroCup Women në Kayseri të Turqisë.

## Ndarja nga jeta e trajnerit Illmen Bajra

20 dhjetori i këtij viti ishte një ditë e rëndë për basketbollin e Kosovës. Në këtë datë ndërroi jetë trajneri i basketbollit Illmen Bajra, duke shokuar komunitetin e basketbollit.

Ai ndërroi jetë në moshën 32 vjeçare, duke lënë të pikëlluar familjen, shoqërinë, por edhe të gjithë basketbolldashësit. Me këtë rast, Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu ka dërguar një telegram ngushëllimi. "Me zemër të thyer e pikëllim të

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të të dashurit tuaj e pjesëtarit të komunitetit tonë - Illmenit.

## Laureatët e vitit 2023, çmimet kryesore i "rrëmbejnë" Përquku dhe Hajrizi

Më 21 dhjetor, Federata e Basketbollit e Kosovës në një ceremoni gala ka organizuar Laureatët e Vitit 2023, ku janë shpallur më të mirët e vitit në basketboll dhe ata që kanë kontribuar për sportin tonë të dashur.

Fillimit janë nderuar veteranët, ku veteran i vitit është shpallur Profesori i nderuar, Masar Nixha, ndërsa veterane, legjenda e basketbollit të femrave, Resmije Juniku. Punëtori më i dalluar sportiv ishte kryetari i KB Vëllaznimit, Ideal Bakija. Ndërkohë, gjyqtari i vitit është shpallur Xhelal Mumini.

Çmimi i publikut i dhuruar nga Art Motion me vota nga publiku kanë shkuar te Elektra Zykaj te femrat dhe Drilon Hajrizi te meshkujt.

Shpresa e Vitit te meshkujt është zgjedhur Jon Ismajli, kurse te femrat Malvina Haziri.

Trajner i vitit 2023 është shpallur Dritëro Sefaja, përzgjedhës i Kosovës U20 të meshkujve dhe i gjeneratave të reja të Kerasanit.

Klubi më i mirë i vitit te meshkujt është shpallur kampionia e Kosovës, Peja.

Ky çmim me plotë meritë te femrat i ka takuar KBF Bashkimit, që fitoi tre trofetë e mundshëm në basketbollin e Kosovës, titullin, Kupën dhe Superkupën.

Pas saj ishte radha për Top 5 te femrat, ku ishin: Arbnore Përquku e Bashkimit, Astera Tuhina, që luan në SHBA, Aulona Muhadri e Bashkimit, Elektra Zykaj e Prishtinës dhe Vanesa Bojku e Penzës.

Te Top 5 meshkujt ishin: Drilon Hajrizi i Trepçës, Arian Qallaku i Pejës, Art Hajdari i Pejës/Sigal Prishtinës/Proton Cable Prizrenit, Dardan Berisha i Sigal Prishtinës dhe Gëzim Morina i Golden Eagle Yllit.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





Basketbollistja më e mirë e vitit është shpallur Arbnore Përçuku, që fitoi tre trofetë me Bashkimin.

Basketbollisti më i mirë i vitit 2023 është shpallur Drilon Hajrizi i Trepçës, që fitoi Kupën e Superkupën, garoi me mitrovicasit në FIBA Europe Cup dhe ishte pjesë e rëndësishme e Përfaqësueses së Kosovës.

Në fund, por jo nga rëndësia kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu, ka zbuluar edhe logon e Superligës së Femrave, si dhe identitetin e ri në basketbollin femëror. Fetahu është shprehur se, kjo është pjesë e projektit të FBK-së dhe Federata gjithmonë i ka kushtuar rëndësi basketbollit të femrave.

Ceremonia ka nisur me një minutë heshtje për ndarjen nga jeta të trajnerit të basketbollit, Ilmen Bajra.

## FBK organizon kampanjë me dhurata për fëmijët

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), në bashkëpunim me klubet dhe sponsorët e saj ka organizuar vizita në qendra të fëmijëve në vende të ndryshme të Kosovës. Vizitat u realizuan në qytetin e Prishtinës, Mitrovicës, Pejës dhe Gjakovës.

Fëmijët patën rastin të takohen me lojtarët e tyre të preferuar duke shkëmbyer përvojat e tyre, ndërsa fëmijët dhuruan dashuri e mirësi pa fund.

FBK është pritur në mënyrë të ngrohtë ku janë njoftuar për punën që po bëhet dhe përkushtimin ndaj fëmijëve. Federata e Basketbollit e Kosovës falënderon përzemërsisht të gjithë palët e përfshira në këtë aktivitet, që për qëllim pati gëzimin e fëmijëve në prag të festive të fund vitit.

## Pensionohet Alban Veseli

Një nga lojtarët më të mirë vendorë në dekadat e fundit vendosi t'i jep fund basketbollit aktiv.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





Numri 8, Alban Veseli, pas shumë trofeve të fituar, mori vendimin aspak të lehtë, për tu larguar nga basketbolli.

Albani ka qenë pjesë e rëndësishme e Përfaqësueses së Kosovës, duke luajtur për Dardanët pas pranimit në FIBA deri më 2021, ku kishte 18 ndeshje me Kosovën dhe kishte paraqitje mjaft të mira. Veseli kishte paraqitje ndërkombëtare me Sigal Prishtinën dhe Pejën, aty ku kaloi pjesën më të madhe të karrierës së tij. Numri 8 luajti në grupet e FIBA Europe Cup dhe kualifikimet e Ligës së Kampionëve, si dhe në Ligën Ballkanike.

"Snajperisti" përveç Sigal Prishtinës dhe Pejës, luajti edhe për Rahovecin, Bashkimin, Ponte Prizrenin e Golden Eagle Yllin. Albani me skuadrën kryeqytetase ka tetë tituj të fituar, ndërsa me atë verdhezi dy tituj (2013 dhe 2023), të vetmit tituj që ka fituar Peja në dekadën e fundit.

## Presidentja nderon legjendat e basketbollit

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në një ceremoni zyrtare ka dekoruar me Medalje Presidenciale të Meritave legjendat e basketbollit të Kosovës, Mithat Belegu, Resmije Juniku dhe Masar Nixha.

Belegu, Juniku dhe Nixha janë legjenda të basketbollit të Kosovës, ku kanë kontribuar me dekada të tëra në sportin tonë të dashur.

Ata kanë merita të mëdha në sukseset e basketbollit të Kosovës dhe pandërprerë kanë ndihmuar e kontribuar në basketboll, duke mos u larguar asnjëherë nga ky sport, shumë i dashur dhe i çmuar për ne.

Për këtë arsye, Presidentja e Kosovës ka ndarë Medalje në shenjë kontributi për ndihmën e dhënë në basketbollin, por edhe sportin e Kosovës.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:

